



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Vendosi:** Gjykatësi i Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 29 shtator 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë të Hysni Gucatit**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 39(6) dhe 41(5) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 55(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar paraqiti kërkesë për nxjerrjen e fletarrestimit dhe urdhrit përkatës për transferim kundër Hysni Gucati (“z. Gucati”).<sup>2</sup>
2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm nxori “Fletarrestimin për Hysni Gucatin”,<sup>3</sup> dhe “Urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara”.<sup>4</sup>
3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati u arrestua<sup>5</sup> dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.<sup>6</sup>
4. Më 28 shtator 2020, Administratorja emëroi Xhonatan Elistan Ris (“z. Ris”) si mbrojtës të z. Gucati në pajtim me pjesët 12 dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00024, *Njoftim për emërimin e mbrojtësit*, 28 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

5. Më të njëjtën ditë, Z. Ris, mbrojtës i z. Gucati, kërkoi që paraqitja e parë e z. Gucati para Gjykatësit të Vetëm të mbahet me 1 tetor 2020 ("kërkesa").<sup>8</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit, një person i privuar nga liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet me mënyrën e udhëtimit të specifikuar në një urdhër të Dhomave të Specializuara dhe sillet pa vonesë para një gjykatësi të Dhomave të Specializuara.

7. Në përputhje me rregullën 55(6) të Rregullores, çdo person i arrestuar sipas fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara nxirret pa vonesë të papërligjur para një paneli i cili duhet të bindet për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat e tij sipas Ligjit dhe Rregullores.

8. Në përputhje me nenin 39(6) të Ligjit, seancat, duke përfshirë dhe paraqitjen e parë të të dyshuarit, janë publike, përveç nëse gjykatësi i Dhomave të Specializuara vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.

## III. DISKUTIM

9. Duke pasur parasysh se arrestimi i z. Gucati dhe transferimi i tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara u bë më 25 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm e konsideron të përshtatshme që ta caktojë datën e seancës për paraqitjen e parë të z. Gucati para tij sa më parë që të jetë e realizueshme, duke pasur parasysh kufizimet për shkak të KOVID-19, me qëllim për të siguruar respektimin e të drejtave të z. Gucati

---

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00025, *Kërkesë për regjistrimin e paraqitjes së parashtruesit të kërkesës para gjykatësit në pajtim me nenin 41(5) të ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 28 shtator 2020, konfidenciale. Një korrigjim me nënshkrimin e mbrojtësit u protokollua më 29 shtator 2020 si F00025/COR. Për të ardhmen, tërhiqet vëmendja e mbrojtësit te neni 29(5)(c) dhe (d) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për dosjet dhe parashtrimet para Dhomave të Specializuara të Kosovës, sipas të cilit kërkohet që data dhe vendi i nënshkrimit të pasqyrohen në faqen e fundit të parashtrimit.

